



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo Finasija – Ministry of Finance

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE
DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MF-NO. 07/2019 ON THE STRUCTURE, CONTENT AND
SUBMISSION OF ANNUAL FINANCIAL REPORTS**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MF-BR 07/2019 O STRUKTURI, SADRŽAJU I PODNOŠENJU
GODIŠNJIH FINANSIJSKIH IZVEŠTAJA**

<p>Ministri i Ministrisë së Financave,</p> <p>Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (Gazeta Zyrtar e Republikës së Kosovës Nr. 06/L-032, datë 19 prill 2018), nenit 8 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011), nxjerr:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetore.</p>	<p>Minister of the Ministry of Finance,</p> <p>Pursuant to Article 14, paragraph 4 of the Law No. 06/L-032 on Accounting, Financial Reporting and Auditing (Official Gazette of the Republic of Kosovo, No. 06 /L-032, dated 19 April 2018), Article 8 sub paragraph 1.4 of Regulation No. 02/2011 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries and Article 38 paragraph 6 of the Government's Rules of Procedure no. 09/2011 (Official Gazette no.15, 12.09.2011), issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MF-NO. 07/2019 ON THE STRUCTURE, CONTENT AND SUBMISSION OF ANNUAL FINANCIAL REPORTS</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to determine the structure and content of annual financial reporting.</p>	<p>Ministar Ministarstva Finansija,</p> <p>Na osnovu člana 14, stav 4 zakona Br. 06/L-032 o Računovodstvu, Finansijskom Izveštavanju i Reviziji (Službeni list Republike Kosovo, br. 06/ L-032, dana 19. aprila 2018), člana 8 podstav 1.4 Pravilnika br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, te člana 38, stav 6 poslovnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni list br.15, 12.09.2011), izdaje:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MF-BR. 07/2019 O STRUKTURI, SADRŽAJU I PODNOŠENJU GODIŠNJIH FINANSIJSKIH IZVEŠTAJA</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Cilj</p> <p>Cilj ovog Administrativnog uputstva je da utvrdi strukturu i sadržaj godišnjeg finansijskog izveštavanja.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjitha shoqëritë tregtare të regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës dhe që janë të obliguara të përgatisin pasqyra financiare sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (këtu e tutje Ligji).</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope of Work</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction are obligatory for all registered business companies that exercise their activity in the Republic of Kosovo and are obliged to prepare financial statements according to the provisions of Law No. 06 / L-032 on Accounting, Financial Reporting and Auditing (hereafter Law).</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Oblast delovanja</p> <p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva su obavezne za sva registrovana privredna društva, koja obavljaju svoju delatnost u Republici Kosovo i obavezna su da pripreme finansijske izveštaje u skladu sa odredbama Zakona Br. 06 /L-032 o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji (u daljem tekstu Zakon).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1. Drejtori ekzekutiv – përfshin pozitën e kryeshefit ekzekutiv apo pozitën më të lartë menaxheriale në ndërmarrje dhe i cili është përgjegjës për udhëheqjen e shoqërisë tregtare;</p> <p>1.2. Zyrtari kryesor financiar – përfshin pozitën e drejtorit financiar apo pozitën më të lartë për financa në ndërmarrje dhe i cili është përgjegjës për udhëheqjen e financave dhe kontabilitetit në shoqëri tregtare; dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. The terms used in this Administrative Instruction have the following meaning:</p> <p>1.1. Executive Director - includes the position of chief executive officer or senior management position in the enterprise and who is responsible for managing the company;</p> <p>1.2. Chief Financial Officer - includes the position of the financial director or the highest position for finance in the enterprise and who is responsible for the management of finance and accounting in the commercial company; and</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovo Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Izvršni direktor - uključuje poziciju izvršnog načelnika ili viši rukovodeći položaj u preduzeću i koji je odgovoran za upravljanje privrednog društva;</p> <p>1.2. Glavni finansijski službenik - uključuje poziciju finansijskog direktora ili višu poziciju za finansije u preduzeću i koji je odgovoran za upravljanje finansijama i računovodstva u privrednim ruštvima; i</p>

<p>1.3. Kontabilist i certifikuar – personi i kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (këtu e tutje KKRF), i cili është anëtar me status të rregullt në një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, dhe emri i tij figuron në listën publike të kontabilistëve të certifikuar të publikuar nga shoqatat e licencuara nga KKRF.</p> <p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtës sipas Ligjit.</p> <p>KAPITULLI II PASQYRAT FINANCIARE</p> <p>Neni 4 Përgatitja dhe hartimi i pasqyrave vjetore financiare</p> <p>1. Shoqëritë tregtare janë të obliguara të përgatisin dhe hartojnë pasqyrat vjetore financiare në pajtueshmëri me standardet e aplikueshme të raportimit financiar sipas Ligjit, si në vijim:</p> <p>1.1. Pasqyrën e pozitës financiare në fund të periudhës raportuese;</p>	<p>1.3. Certified Accountant - Qualified Person as an Certified Accountant by an Association Licensed by the Kosovo Financial Reporting Council (hereafter KCFR), which is a member of regular status in a professional accounting and auditing association, and the name it is listed on the public list of certified accountants published by associations licensed by KFRC.</p> <p>2. Other terms used in this Administrative Instruction have the same meaning according to the Law.</p> <p>CHAPTER II FINANCIAL STATEMENTS</p> <p>Article 4 Preparation and drafting of annual financial statements</p> <p>1. Business Organizations are obliged to prepare and draft annual financial statements in accordance with applicable financial reporting standards under the Law, as follows:</p> <p>1.1. Statement of financial position at the end of the reporting period;</p>	<p>1.3. Sertifikovani računovođa – Kvalifikovano lice kao sertifikovani računovođa od strane Udruženja licencirano od strane Kosovskog saveta za finansijsko izveštavanje (u daljem tekstu KSFI), koji je član redovnog statusa u profesionalno udruženje računovodstva i revizije, i njegovo ime se pojavljuje na javnoj listi sertifikovanih računovođa objavljeni od strane licenciranog udruženja od strane KKRF-a.</p> <p>2. Drugi izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju isto značenje kao u Zakonu.</p> <p>POGLAVLJE II FINANSIJSKI IZVEŠTAJI</p> <p>Član 4 Priprema i izrada godišnjih finansijskih izveštaja</p> <p>1. Privredna društva dužna su da pripremaju i sastavljaju godišnje finansijske izveštaje u skladu sa važećim standardima finansijskog izveštavanja u skladu sa Zakonom, kao što sledi:</p> <p>1.1. Izveštaj o finansijskoj poziciji na kraju izveštajnog perioda;</p>
---	--	--

<p>1.2. Pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse për periudhën raportuese;</p> <p>1.3. Pasqyrën e rrjedhës së parasë për periudhën raportuese;</p> <p>1.4. Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për periudhën raportuese; dhe</p> <p>1.5. Shënime të cilat përbëjnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.</p>	<p>1.2. Statement of comprehensive income for the reporting period;</p> <p>1.3. Cash flow statement for the reporting period;</p> <p>1.4. Statement of changes in equity for the reporting period; and</p> <p>1.5. Data that comprise a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.</p>	<p>1.2. Izveštaj o sveobuhvatnim prihodima za izveštajni period;</p> <p>1.3. Izveštaj o tokovima gotovine za izveštajni period;</p> <p>1.4. Izveštaj o promenama u kapitalu za izveštajni period; i</p> <p>1.5. Napomene koje sadrže sažetak značajnih računovodstvenih politika i druga objašnjavajuća objašnjenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Të dhënat në pasqyrat financiare</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Data in the financial statements</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Podaci u finansijskim izveštajima</p>
<p>Të dhënat në pasqyrën e pozitës financiare në fund të periudhës, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse për periudhën, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit (ekuitetit) dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë, paraqiten për vitin paraprak dhe vitin vijues në valutën euro (€).</p>	<p>The statement of financial position at the end of the period, the statement of comprehensive income for the period, the statement of changes in equity (equity) and the cash flow statement, are presented for the previous year and the following year in the euro currency (€).</p>	<p>Podaci u izveštaju o finansijskoj poziciji na kraju perioda, izveštaj o sveobuhvatnim prihodima za period, izveštaj o promenama na kapitalu (ekuitet) i izveštaj o novčanom toku, prikazuju se za prethodnu godinu i sledeću godinu u evrima (€).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Ndërmarrjet e mëdha dhe subjektet tjera me interes publik</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Large enterprises and other subjects of public interest</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Velika preduzeća i drugi subjekti od javnog interesa</p>
<p>1. Shoqëritë tregtare të klasifikuara si ndërmarrje të mëdha dhe subjektet tjera me interes publik të cilat janë të obliguara të</p>	<p>1. Business Organizations classified as large enterprises and other public interest entities that are required to apply the</p>	<p>1. Privredna društva klasifikovana kao velika preduzeća i drugi subjekti od javnog interesa koja su obavezna da sprovede</p>

<p>zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiare (këtu e tutje SNRF) sipas Ligjit, pasqyrave financiare i bashkëngjisin dokumentet si në vijim:</p> <p>1.1. opinionin e auditimit për pasqyra financiare të dhëna nga një firmë e auditimit e certifikuar nga KKRF-ja dhe e regjistruar në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. opinionin nëse raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për të njëjtin vit financiar dhe nëse raporti i menaxhmentit është përgatitur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;</p> <p>1.3. deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar, që pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve dhe rrjedhave të parasë;</p> <p>1.4. raportin e menaxhmentit, i cili përmban një vlerësim të drejtë të zhvillimit dhe performancës së ndërmarrjes, si dhe pozitën e saj, përfshirë këtu edhe rreziqet kryesore dhe pasiguritë që kanë të bëjnë me të. Vlerësimi duhet të jetë i balancuar dhe</p>	<p>International Financial Reporting Standards (hereinafter IFRSs) under the Law, to the financial statements will attach the following financial statements:</p> <p>1.1. the audit opinion for financial statements provided by an audit firm certified by the KFRC and registered in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. the opinion whether the management report is in accordance with the financial statements for the same financial year and whether the management report has been prepared in accordance with the applicable legal provisions;</p> <p>1.3. the statement of compliance signed by the chief executive officer and the chief financial officer, that the financial statements present a true and fair view of the financial position, results of operations and cash flows;</p> <p>1.4. the management report, which contains a fair assessment of the development and performance of the enterprise, as well as its position, including the main risks and uncertainties associated with it. The assessment should be balanced and</p>	<p>Međunarodne standarde finansijskog izveštavanja (u daljem tekstu: MSFI) u skladu sa Zakonom, finansijskim izveštajima prilažu sledeće dokumente:</p> <p>1.1. revizorsko mišljenje za finansijske izveštaje, dato od revizorske firme, sertifikovane od KSFI i registrovana u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. mišljenje da li izveštaj menadžmenta je u skladu sa finansijskim izveštajima za istu finansijsku godinu i da li je izveštaj menadžmenta pripremljen u skladu sa važećim zakonskim odredbama;</p> <p>1.3. izjavu o usklađenosti koju potpisuju izvršni direktor i glavni finansijski službenik, da finansijski izveštaji predstavljaju istinit i fer prikaz finansijske pozicije, rezultata poslovanja i tokova gotovine;</p> <p>1.4. izveštaj menadžmenta, koji sadrži korektnu procenu razvoja i učinka preduzeća, kao i njegov položaj, uključujući i glavne rizike i neizvesnosti koje su povezane sa njim. Procena treba da bude uravnotežena i sveobuhvatna u odnosu na razvoj i učinak preduzeća i</p>
--	--	--

<p>gjithëpërfshirës në raport me zhvillimin dhe performancën e ndërmarrjes dhe pozitën e saj, në bazë të kompleksitetit dhe madhësisë së ndërmarrjes. Me qëllim të informimit të plotë në drejtim të zhvillimit, performancës dhe pozitës financiare së ndërmarrjes, vlerësimi përfshin, aty ku është e përshtatshme, treguesit financiar dhe jo financiar të performancës së kompanisë, përfshirë informacionet në lidhje me çështjet e mjedisit dhe të punëtorëve. Aty ku është e përshtatshme, analiza i referohet të dhënave në pasqyrat financiare. Raporti i menaxhmentit përfshin së paku informacionin e mëposhtëm:</p> <p>1.4.1. zhvillimet e mundshme të ndërmarrjes në të ardhmen;</p> <p>1.4.2. aktivitetet në fushën e kërkimit dhe zhvillimit;</p> <p>1.4.3. listën e departamenteve kryesore të ndërmarrjes; dhe</p> <p>1.4.4. ekspozimin e ndërmarrjes ndaj rreziqeve të kreditimit, të çmimeve, të likuiditetit dhe të rrjedhës së parasë.</p> <p>1.5. deklaratën e qeverisjes korporative, si pjesë e veçantë e</p>	<p>comprehensive in relation to the development and performance of the enterprise and its position, based on the complexity and size of the enterprise. For the purpose of providing full information on the development, performance and financial position of the enterprise. The assessment includes, where appropriate, the financial and non-financial performance indicators of the company, including information on environmental issues and employees. Where appropriate, the analysis refers to the data in the financial statements. The management report includes at least the following information:</p> <p>1.4.1. future developments of the enterprise;</p> <p>1.4.2. activities in the field of research and development;</p> <p>1.4.3. the list of the main departments of the enterprise; and</p> <p>1.4.4. the exposure of the enterprise to the credit, price, liquidity and cash flow risks.</p> <p>1.5. the Corporate Governance Statement as a separate part of the</p>	<p>njegov položaj, na osnovu složenosti i veličine preduzeća. U cilju pružanja potpunih informacija o razvoju, učinku i finansijskom položaju preduzeća, procena uključuje, gde je to prikladno, finansijske i nefinansijske pokazatelje učinka kompanije, uključujući informacije o pitanju životne sredine i radnicima. Kada je to prikladno, analiza se odnosi na podatke u finansijskim izveštajima. Izveštaj menadžmenta sadrži najmanje sledeće informacije:</p> <p>1.4.1. mogući razvoj preduzeća u budućnosti;</p> <p>1.4.2. aktivnosti u oblasti istraživanja i razvoja;</p> <p>1.4.3. spisak glavnih odeljenja preduzeća; i</p> <p>1.4.4. izloženost preduzeća kreditnom, cenovnom, likvidnom riziku i novčanog toka.</p> <p>1.5. Izjavu o korporativnom upravljanju kao poseban deo izveštaja</p>
---	---	--

<p>raportit të menaxhmentit dhe përmban të paktën informacionet e mëposhtme:</p> <p>1.5.1. të gjitha informacionet në lidhje me praktikën e qeverisjes korporative;</p> <p>1.5.2. përshkrim të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut në lidhje me procesin e raportimit financiar; dhe</p> <p>1.5.3. përbërjen dhe funksionimin e organeve menaxheriale dhe mbikëqyrëse dhe komitetet e tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla</p> <p>1. Shoqëritë tregtare të klasifikuara si ndërmarrje të mesme dhe të vogla përgatisin pasqyrat e tyre financiare për qëllime të përgjithshme në përputhje me SNRF për NVM-të, sipas specifikave si në vijim:</p> <p>1.1. ndërmarrjet të cilat i plotësojnë kriteret e nenit 5, paragrafëve 3, 4, 9, dhe 10 të Ligjit (ndërmarrje të mesme, ndërmarrje të vogla, grupe të mesme apo grupe të vogla), me qarkullim vjetor neto mbi katër milion euro</p>	<p>Management Report and contains at least the following information:</p> <p>1.5.1. all information about corporate governance practices;</p> <p>1.5.2. description of internal control systems and risk management related to the financial reporting process; and</p> <p>1.5.3. composition and functioning of the managerial and supervisory bodies and their committees.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Small and medium enterprises</p> <p>1. Trading Companies classified as medium and small enterprises shall prepare their financial statements for general purpose in accordance with IFRS for SMEs, according to the following specifications:</p> <p>1.1. enterprises which meet the criteria of Article 5, paragraphs 3, 4, 9 and 10 of the Law (medium-sized enterprises, small enterprises, small group or small groups) with net annual turnover of over four million euro (4,000,000.00 €) will</p>	<p>menadžmenta i sadrži najmanje sledeće informacije:</p> <p>1.5.1. sve informacije o praksi korporativnog upravljanja;</p> <p>1.5.2. opis sistema unutrašnje kontrole i upravljanja rizicima u vezi sa procesom finansijskog izveštavanja; i</p> <p>1.5.3. sastav i funkcionisanje upravnih i nadzornih organa i njihovih komiteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Mala i srednja preduzeća</p> <p>1. Privredna društva, klasifikovana kao srednja i mala preduzeća pripremaju njihove finansijske izveštaje za opšte namene u skladu sa MSFI za mala i srednja preduzeća, na osnovu sledećih specifikacija:</p> <p>1.1. preduzeća koja ispunjavaju kriterijume iz člana 5 stav 3, 4, 9 i 10 Zakona (srednja preduzeća, mala preduzeća, srednje grupe ili male grupe) sa neto godišnjim prometom od preko četiri miliona evra (4.000.000,00 €)</p>
---	---	--

<p>(4,000,000.00 €), bashkëngjishtin opinionin e auditimit për pasqyrat financiare të dhënë nga një firmë e auditimit të regjistruar në Kosovë, dhe deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar që vërtetojnë se pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, rrjedhës së parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me këtë Ligj; dhe</p> <p>1.2. ndërmarrjet të cilat i plotësojnë kriteret e nenit 5, paragrafëve 3, 4, 9 dhe 10 të Ligjit (ndërmarrje të mesme, ndërmarrje të vogla, grupe të mesme apo grupe të vogla) me qarkullim vjetor neto më pak ose të barabartë me katër milion euro (4,000,000.00 €) i bashkangjesin pasqyrave financiare raportin e rishikimit të auditorit të pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Angazhimet në Rishikim (këtu e tutje SNAR).</p> <p>2. Me qëllim të përcaktimit të kërkesës për auditim apo për rishikim të pasqyrave financiare të kategorisë së ndërmarrjeve të përcaktuara me këtë nen, si kriter merret qarkullimi vjetor neto i specifikuar në nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni.</p>	<p>attach the audit opinion to the financial statements provided by an audit firm registered in Kosovo and a compliance statement signed by the chief executive officer and the chief financial officer attesting that the financial statements present a true and fair view of the financial position, the results of operations, cash flows and that the financial statements have been prepared in accordance with this Law; and</p> <p>1.2. enterprises which meet the criteria of Article 5, paragraphs 3, 4, 9 and 10 of the Law (medium-sized enterprises, small enterprises, small group or small groups) with a net annual turnover of less than or equal to four million euro (4,000,000.00 €) will attach to the financial statements the Independent Auditor's review report in accordance with International Standards on Undertaking Review (hereafter SNAR).</p> <p>2. For the purposes of determining the requirement for audit or review of the financial statements of the enterprise category as defined in this Article, the net annual turnover specified in sub-</p>	<p>prilažu revizorsko mišljenje o finansijskim izveštajima koje je dala revizorska firma registrovana na Kosovu i izjavu o usklađenosti koju je popisao izvršni direktor i glavni finansijski službenik i potvrđuju da finansijski izveštaji predstavljaju istinit i fer prikaz finansijske pozicije, rezultata poslovanja, toka novca i da su finansijski izveštaji pripremljeni u skladu sa ovim zakonom; i</p> <p>1.2. preduzeća koja ispunjavaju kriterijume iz člana 5, stav 3, 4, 9 i 10 Zakona (srednja preduzeća, mala preduzeća, srednje grupe ili male grupe) sa neto godišnjim prometom manjim od ili jednakim četiri miliona evra (4,000,000.00 €) prilažu finansijskim izveštajima izveštaj revidiranja nezavisnog revizora u skladu sa Međunarodnim standardima za angažovanje i revidiranje (u daljem tekstu MSAR).</p> <p>2. U cilju utvrđivanja zahteva za reviziju ili za revidiranje finansijskih izveštaja kategorije preduzeća definisano u ovom članu, kao kriterijum uzima se neto godišnji promet naveden u pod-stavu 1.1 i 1.2 ovog člana.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 8 Nënshkrimi i pasqyrave financiare</p> <p>1. Pasqyrat financiare të përgatitura sipas nenit 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe nga zyrtari kryesor financiar.</p> <p>2. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i certifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i certifikuar.</p>	<p>paragraphs 1.1 and 1.2 of this Article shall be taken as the criterion.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Signature of financial statements</p> <p>1. The financial statements prepared in accordance with Articles 6 and 7 of this Administrative Instruction shall be signed by the Executive Director and the Chief Financial Officer.</p> <p>2. If the financial director or chief financial officer is not certified as an accountant, then the certified statements are also signed by the financial accountant.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Potpisivanje finansijskih izveštaja</p> <p>1. Finansijske izveštaje pripremljeni u skladu sa članom 6 i 7 ovog Administrativnog uputstva potpisuje izvršni direktor i glavni finansijski službenik.</p> <p>2. Ako finansijski direktor ili glavni finansijski službenik nije sertifikovan kao računovođa, onda izveštaje potpisuje i sertifikovani računovođa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare në KKRF</p> <p>1. Ndërmarrjet e mëdha dorëzojnë në KKRF për publikim pasqyrat vjetore financiare, raportin e menaxhmentit dhe raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare deri më tridhjetë (30) prill të vitit vijues. Ndërmarrjet e mëdha të cilat kanë obligim të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë jo më vonë se më tridhjetë (30) qershor të vitit vijues.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Submission and publication of financial statements to KFRC</p> <p>1. Large enterprises will submit to the KFRC for publication of the annual financial statements, the management report and the audit report of the annual financial statements until the thirtieth (30) April of the following year. Large enterprises that have an obligation to prepare consolidated financial statements shall have their term of delivery no later than thirty (30) June of the following year.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Podnošenje i objavljivanje finansijskih izveštaja KSFI-a</p> <p>1. Velika preduzeća dostavljaju KSFI za objavljivanje godišnje finansijske izveštaje, izveštaj menadžmenta i izveštaj revizije godišnjih finansijskih izveštaja do tridesetog (30) aprila sledeće godine. Velika preduzeća koja imaju obavezu da pripremaju konsolidovane finansijske izveštaje imaju rok za podnošenje najkasnije do trideset (30) juna naredne godine.</p>

<p>2. Ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme dorëzojnë në KKRF vendimet për miratimin e pasqyrave vjetore financiare apo të konsoliduara nga autoriteti kompetent dhe vendimin mbi propozimin për shpërndarjen e fitimeve ose humbjeve, nëse nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare vjetore apo të konsoliduara ose raporteve vjetore përkatësisht raporteve vjetore të konsoliduara.</p>	<p>2. Large and medium-sized enterprises will submit to KCFR the decisions for approval of annual financial statements or consolidated by the competent authority and decision on the proposal for the distribution of gains or losses if they are not an integral part of annual or consolidated financial statements or annual reports, respectively consolidated annual reports.</p>	<p>2. Velika i srednja preduzeća dostavljaju KSFI-u odluke za odobravanje godišnjih finansijskih ili konsolidovanih izveštaja od strane nadležnog organa i odluku o predlogu za raspodelu dobitaka ili gubitaka ako nisu sastavni deo godišnjih ili konsolidovanih finansijskih izveštaja ili godišnjih izveštaja, odnosno godišnjih konsolidovanih izveštaja.</p>
<p>3. Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla të cilat kanë qarkullim vjetor neto mbi katër milion euro (4,000,000.00 €) dorëzojnë në KKRF për publikim pasqyrat vjetore financiare dhe raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare deri më tridhjetë (30) prill të vitit vijues. Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla të cilat kanë obligim të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë deri më tridhjetë (30) qershor të vitit vijues.</p>	<p>3. Medium and small enterprises that have net annual turnover above € 4 million (€ 4,000,000.00) will submit to the KFRC for publication of the annual financial statements and the audit report of the annual financial statements until the thirtieth (30) April of the following year. Small and medium enterprises that have an obligation to prepare consolidated financial statements have a term of delivery up to thirty (30) June of the following year.</p>	<p>3. Srednja i mala preduzeća koja imaju neto godišnji promet veći od četiri miliona evra (4,000,000.00 €) podnose KSFI-u za objavljivanje godišnje finansijske izveštaje i izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja do tridesetog (30) aprila sledeće godine. Mala i srednja preduzeća koja su dužna da pripreme konsolidovane finansijske izveštaje imaju rok za podnošenje do tridesetog (30) juna naredne godine.</p>
<p>4. Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla të cilat kanë qarkullim vjetor neto më pak se katër milion euro (4,000,000.00 €) dorëzojnë në KKRF pasqyrat vjetore financiare dhe raportin e rishikimit të pasqyrave vjetore financiare deri më tridhjetë (30) prill të vitit vijues. Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla të cilat kanë obligim të përgatisin pasqyra</p>	<p>4. Medium and small enterprises that have net annual turnover of less than € 4 million (€ 4,000,000.00) will submit to the KFRC the annual financial statements and the report on the review of the annual financial statements until the thirtieth of (30) April of the following year. Small and medium enterprises that have an obligation to prepare consolidated financial statements</p>	<p>4. Mala i srednja preduzeća koja imaju neto godišnji promet manji od četiri miliona evra (4,000,000.00 €) dostavljaju KSFI -u godišnje finansijske izveštaje i izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja do tridesetog (30) aprila naredne godine. Mala i srednja preduzeća koja su dužna da pripreme konsolidovane finansijske</p>

<p>financiare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë deri më tridhjetë (30) qershor të vitit vijues.</p> <p>5. Mikro-ndërmarrjet dorëzojnë në KKRF pasqyrat vjetore financiare deri më tridhjetë (30) prill të vitit vijues. Mikro-ndërmarrjet të cilat kanë obligim të përgatisin pasqyra financiarare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë deri më tridhjetë (30) qershor të vitit vijues.</p> <p>6. Ndërmarrjet të cilat gjatë vitit kalendarik (kontabël) nuk kanë pasur aktivitet biznesor dhe nuk kanë regjistruar asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet e tyre në librat kontabël i dorëzojnë KKRF-së deklaratën për pasivitet të vitit paraprak afarist deri më tridhjetë e një (31) mars të vitit në vijim.</p> <p>7. Të gjitha raportet sipas këtij neni dorëzohen në KKRF në formë fizike dhe elektronike.</p>	<p>have a term of delivery up to thirty (30) June of the following year.</p> <p>5. Micro-enterprises will submit to the KFRC the annual financial statements until the thirtieth (30) April of the following year. Micro-enterprises that have an obligation to prepare consolidated financial statements, have a term of delivery up to thirty (30) June of the following year.</p> <p>6. Enterprises which during the calendar year (accounting) did not have any business activity and did not register any data on their assets and liabilities in the accounting books will submit to the KFRC a declaration of inactivity for the prior business year until the thirty first (31) March of the following year.</p> <p>7. All reports under this Article shall be submitted to the KFRC in physical and electronic form.</p>	<p>izveštaje imaju rok podnošenja do tridesetog (30) juna naredne godine.</p> <p>5. Mikro-preduzeća podnose KSFI-u godišnje finansijske izveštaje do tridesetog (30) aprila sledeće godine. Mikro-preduzeća koja su dužna da pripreme konsolidovane finansijske izveštaje imaju rok podnošenja do tridesetog (30) juna naredne godine.</p> <p>6. Preduzeća koja tokom kalendarske godine (računovodstvo) nisu imala nikakvu poslovnu aktivnost i nisu registrovali nikakve podatke o svojim sredstvima i obavezama u računovodstvenim knjigama podnose KSFI izjavu o neaktivnosti za prethodnu poslovnu godinu do trideset prvog (31) mart naredne godine.</p> <p>7. Svi izveštaji u skladu sa ovim članom podnose se KSFI-u u fizičkom i elektronskom obliku.</p>
---	---	--

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	CHAPTER III FINAL PROVISIONS	POGLAVLJE III ZAVRŠNE ODREDBE
<p style="text-align: center;">Neni 10 Shtojcat</p> <p>1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë Shtojcat si në vijim:</p> <p>1.1. Shtojca Nr. 1 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare individuale në pajtueshmëri me SNRF për NVM-të;</p> <p>1.2. Shtojca Nr. 2 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare të konsoliduara në pajtueshmëri me SNRF për NVM-të;</p> <p>1.3. Shtojca Nr. 3 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare individuale në pajtueshmëri me SNRF/SNK; dhe</p> <p>1.4. Shtojca Nr. 4 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare të konsoliduara në pajtueshmëri me SNRF/SNK.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Appendices</p> <p>1. The following Appendices are an integral part of this Administrative Instruction:</p> <p>1.1. Appendix Br. 1 - Illustrative model of presentation of individual financial statements in accordance with IFRS for SMEs</p> <p>1.2. Appendix No. 2 - Illustrative model of presentation of consolidated individual financial statements in accordance with IFRS for SMEs</p> <p>1.3. Appendix No. 3 - Illustrative model of presentation of individual financial statements in accordance with IFRS for ISA; and</p> <p>1.4. Appendix No. 4 - Illustrative model of presentation of consolidated individual financial statements in accordance with IFRS for ISA</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Prilozi</p> <p>1. Sledeći prilozi su sastavni deo ovog administrativnog uputstva:</p> <p>1.1. Prilog Br. 1 - Ilustrativni model prezentacije pojedinačnih finansijskih izveštaja u skladu sa MSFI za MSP;</p> <p>1.2. Prilog Br. 2 - Ilustrovani model prezentacije konsolidovanih finansijskih izveštaja u skladu sa MSFI za MSP;</p> <p>1.3. Prilog Br. 3 - Ilustrativni model prezentacije pojedinačnih finansijskih pregleda u skladu sa MSFI /MRS; i</p> <p>1.4. Prilog Br. 4 - Ilustrovani model prezentacije konsolidovanih finansijskih izveštaja u skladu sa MSFI/ MRS.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 11 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ i shfuqizon Udhëzimet Administrative, si në vijim:</p> <p>1.1. Udhëzimi Administrativ MF-nr. 04/2015 për Strukturën dhe Përmbajtjen e Pasqyrave Financiare Vjetore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme; dhe</p> <p>1.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raportimeve Financiare Vjetore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza (e nënshkruar)</p> <p style="text-align: right;">_____ Ministër i Financave Datë: 20/12/2019</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Abrogating Provisions</p> <p>1. This Administrative Instruction shall supersede the following Administrative Instructions:</p> <p>1.1 Administrative Instruction MF no. 04/2015 on Structure and Contents of Annual Financial Statements for Small and Medium Enterprises; and</p> <p>1.2. Administrative Instruction no. 2/2013 / MoF on Structure and Content of Annual Financial Reports.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Entry into force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza (signed)</p> <p style="text-align: right;">_____ Minister of Finance Date 20/12/2019</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Odredbe van snage</p> <p>1. Ovo Administrativno uputstvo stavlja van snage sledeća Administrativna uputstva:</p> <p>1.1 Administrativno uputstvo MF br. 04/2015 o strukturi i sadržini godišnjih finansijskih izveštaja za mala i srednja preduzeća; i</p> <p>1.2. Administrativno uputstvo br. 2/2013 / MF o strukturi i sadržaju godišnjih finansijskih izveštaja.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza (potpisen)</p> <p style="text-align: right;">_____ Ministara Finansija Dana: 20/12/2019</p>
--	--	--

SHTOJCA Nr. 1

**Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare individuale në
pajtueshmëri me SNRF për NVM-të**

Hyrje

Këtë model të prezantimit të pasqyrave financiare duhet ta aplikojnë të gjitha NVM-të të cilat **përgatisin pasqyra financiare individuale (jo të konsoliduara)**.

Në këtë model ilustrues janë përfshirë:

1. **Pasqyra e pozitës financiare** në datën raportuese;
2. **Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse** për periudhën raportuese;
3. **Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet** për periudhën raportuese;
4. **Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme** për periudhën raportuese;

Shënim:

Ky model ilustrues është përgatitur që tu lehtësohet përgatitësve të pasqyrave financiare aplikimi i drejtë i **formës së prezantimit** të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me kërkesat e SNRF-së për NVM-të. Janë bërë të gjitha përpjekjet që ky model të jetë sa më i saktë. Ky model i pasqyrave financiare nuk pretendon që të përfshijë të gjitha kërkesat dhe aspektet e SNRF-së për NVM-të, ose të jetë zëvendësues i tij. Gjithashtu, në këtë model nuk janë të përfshira shpalosjet e mundshme të cilat kërkohet sipas SNRF-së për NVM-të. **Andaj rekomandohet që përgatitësit, për të qenë në pajtueshmëri të plotë me Standardin, duhet ti referohen Standardit dhe të implementojnë drejtë të gjitha kërkesat e SNRF-së për NVM-të.**

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 20xy

	Shënimi	20xy €	20xx €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	x	Xxxx	xxxx
Investimet financiare afatshkurtra	X	Xxxx	xxxx
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	X	Xxxx	xxxx
Stoqet	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatshkurtra	X	Xxxx	xxxx
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje	X	Xxxx	xxxx
Investimet në filiale	X	Xxxx	xxxx
Investimet financiare afatgjata	X	Xxxx	xxxx
Prona, pajisjet dhe impiantet	X	Xxxx	xxxx
Prona investuese	X	Xxxx	xxxx
Investimet në vijim	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e paprekshme	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e shtyra tatimore	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatgjata	X	Xxxx	xxxx
Gjithsej pasuritë afatgjata		<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
Gjithsej pasuritë		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		xxxx	xxxx
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	X	xxxx	xxxx
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	X	xxxx	xxxx
Interesi i pagueshëm	X	xxxx	xxxx
Tatimin në fitim i pagueshëm	X	xxxx	xxxx
Provizionet afatshkurtra	X	xxxx	xxxx
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër	X	xxxx	xxxx
Detyrimet e tjera afatshkurtra	X	xxxx	xxxx
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>

Detyrimet afatgjata

Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	X	xxxx	xxxx
Provizionet afatgjata		xxxx	xxxx
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjatë	X	xxxx	xxxx
Detyrimet e shtyra tatimore	X	xxxx	xxxx
Detyrimet e tjera afatgjata	X	xxxx	xxxx
Gjithsej detyrimet afatgjata		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
		xxxx	xxxx

Gjithsej detyrimet**EKUITETI**

Kapitali aksionar	X	xxxx	xxxx
Fitimet e mbajtura	X	xxxx	xxxx
Rezervat e tjera	X	xxxx	xxxx
Gjithsej ekuiteti		<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>

Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet

		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
		xxxx	xxxx

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori financiar/Kontabilisti i

Certifikuar

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

	Shënimi	20xy €	20xx €
Të hyrat	X	Xxxx	Xxxx
Kostoja e shitjes	X	(xxxx)	(xxxx)
Fitimi / (humbja) bruto		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Të ardhurat tjera	X	xxxx	Xxxx
Shpenzimet e shpërndarjes	X	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet administrative	X	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e tjera	X	(xxxx)	(xxxx)
Fitimi / (humbja) operativ		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Shpenzimet financiare	X	(xxxx)	(xxxx)
Të ardhurat financiare	X	xxxx	Xxxx
Fitimi / (humbja) para tatimit		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Shpenzimet e tatimit në fitim	X	(xxxx)	(xxxx)
Fitimi / (humbja) i/e vitit		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi	X	Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xx

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 20xx	<u>xxxx</u>	<u>xxxx / (xxxx)</u>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Dividendat	-	(xxxx)	-	(xxxx)
Deponimet e kapitalit shtesë	xxxx	-	-	xxxx
Ndarja e rezervave	-	(xxxx)	xxxx	-
Gjendja më 31 dhjetor 20xx	<u>xxxx</u>	<u>xxxx / (xxxx)</u>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
Dividendat	-	(xxxx)	-	(xxxx)
Deponimet e kapitalit shtesë	xxxx	-	-	xxxx
Ndarja e rezervave	-	(xxxx)	xxxx	-
Gjendja më 31 dhjetor 20xy	<u>xxxx</u>	<u>xxxx / (xxxx)</u>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

Shënimi	20xy €	20xx €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	Xxxx	Xxxx
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	Xxxx	Xxxx
Amortizimi i pasurive të paprekshme	Xxxx	Xxxx
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	Xxxx	Xxxx
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	Xxxx	Xxxx
Të ardhurat financiare	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet financiare	Xxxx	Xxxx
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	(Xxxx)/xxxx	(Xxxx)/xxxx
Shpenzimet e tatimit në fitim	Xxxx	Xxxx
	Xxxx	Xxxx
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
	xxxx	Xxxx
Tatimi në fitim i paguar	(xxxx)	(xxxx)
Interesi i paguar	(xxxx)	(xxxx)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	xxxx	Xxxx
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	xxxx	Xxxx
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	xxxx	xxxx
Interesi i arkëtuar	xxxx	xxxx
Dividendat e arkëtuara	xxxx	xxxx
	(xxxx)	(xxxx)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(xxxx)

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese

Deponimet e kapitalit shtesë	Xxxx	xxxx
Dividendat e paguara	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	xxxx	xxxx
Ripagimi i kredive dhe huave	(xxxx)	(xxxx)
Pagesat e lizingut financiar	(xxxx)	(xxxx)

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese

<u>(xxxx)</u>	<u>(xxxx)</u>
---------------	---------------

Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë

xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
---------------	---------------

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit

xxxx	Xxxx
------	------

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit

x	<u>xxxx</u>	<u>Xxxx</u>
---	-------------	-------------

SHTOJCA Nr. 2

Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare të konsoliduara në pajtueshmëri me SNRF për NVM-të

Hyrje

Këtë model të prezantimit të pasqyrave financiare duhet ta aplikojnë të gjitha NVM-të të cilat **përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara**.

Në këtë model ilustrues janë përfshirë:

1. **Pasqyra e pozitës financiare** në datën raportuese;
2. **Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse** për periudhën raportuese;
3. **Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet** për periudhën raportuese;
4. **Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme** për periudhën raportuese;

Shënim:

